



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJE DHE
LARGIMIT E PERPUNIMIT TË UJERAVE TË NDOTURA

VENDIM
Nr. 50, datë 30.12.2013

PER MIRATIMIN E FORMATIT TË LICENCËS DHE DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN E LICENCIMIT

Në zbatim të nenit 14, gërma “e” dhe “i”, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, për “Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Të miratojë formatin e licencës sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij;
2. Formatin e licencës përbëhet nga certifikata e licencës dhe kushtet e licencës të cilat nënshkruhen nga ERRU;
3. Në rregulloren e licencimit bëhen këto ndryshime:
 - a. Në nenin 5, pika 2, fjalia e parë “*Rinovimi i licencës brenda këtij afati për shkak të ndryshimit të drejtuesit teknik apo ligjor do të ketë kohëzgjatjen e licencës*”, shfuqizohet;
 - b. Në nenin 9, pika “d”, togfjalëshi “*deri në vendimmarrjen e KKRRU*”, shfuqizohet;
 - c. Në nenin 11, paragrafi i katërt, togfjalëshi “*ndryshimi i drejtuesit ligjor apo teknik*”, shfuqizohet;
 - d. Neni 11/1 shfuqizohet;
 - e. Në nenin 12, pas paragrafit të fundit shtohet fjalia “*Kushtet e detajuara të licencës dhe certifikata e licencës gjenden në aneksin 6 të rregullores*”;
4. Licencat e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të ndryshojnë sipas modelit të ri brenda datës 30 Qershor 2014;
5. Vendimi nr.25, datë 02.12.2009 “Për miratimin e formatit të licencës”, shfuqizohet;
6. Ngarkohen Sektori Juridik dhe Marrdhenieve me Publikun dhe Sektori Teknik dhe IT për zbatimin e këtij vendimi;

Ky vendim hyn në fuqi më datë 30.12.2013.

KRYETARI
Avni Dervishi